

Pranuar më: 30.08 2021		
Priljeno: 30.08 2021		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-030-	51230	

I. Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson drejtori z. Mahmoud Abbas Shaker, tutje referuar si **pala e parë**, dhe:

II. Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson kryetari z. Imri Ahmeti tutje referuar si **pala e dytë**,

Më datën 25/08/2021, lidhin këtë :

Memorandum Bashkëpunimi Për dhurimin e çantave me material shkollorë

Neni 1

Objekti i Memorandumit

Objekt i Memorandumit të Bashkëpunimit është dhurimi i (500) pesëqind çantave me material shkollorë (sasia dhe detajet e materialit shkollorë janë të cekura në kërkesën e dërguar për bashkëpunim), për nxënësit e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Obligimet e palës së parë

Pala e parë nënshkruese, merr përsipër të gjitha shpenzimet e realizimit të këtij projekti, ku përfshihen: blerja, paketimi, dhe transporti deri në Komunën e Lipjanit.

Neni 3

Obligimet e palës së dytë

Pala e dytë nënshkruese, merr përsipër sigurimin e listave me përfituesit, në pajtueshmëri me rregulloren e Republikës së Kosovës, duke iu dhënë përparësi nxënëseve me kushte të rënda sociale, hendikepëve dhe jetimëve.

Pala e dytë nënshkruese, siguron mjetet transportuese nga zyrat e Komunës deri tek shkolla përfituese për realizimin e shpërndarjes si dhe cakton personin/zyrtarin kontaktues mes palëve nënshkruese, për të siguruar mbarrëvajtjen e projektit.

Neni 4

Obligimet e ndërsjella

Kontaktet mes dy palëve dhe procedurat deri në kohën e nënshkrimit të memorandumit konsiderohen plotësuese të këtij memorandumit.

Palës së parë, duhet t'iu mundësohet fotografimi i ecurive të shpërndarjes.

Neni 5

Afati dhe mënyra e realizimit

Palët nënshkruese pajtohen që mënyra e shpërndarjes, vendi dhe koha do të caktohen në koordinim mes dy palëve

Neni 6

Të përgjithshme

Palët nënshkruese pajtohen për pikat si në vijim:

- Respektimi i të drejtave të fëmijës, mbrojtja e grupeve të marginalizuara dhe mos lejimi i ndonjë pale të shfrytëzojë ato apo të shkelë të drejtat e tyre;
- Respektimi i parimit të transparencës dhe rregullave të anti-korrupsionit dhe nepotizmit;
- Respektimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare;
- Respektimi i ligjit dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me pastrim parash, apo financim të terrorizmit.

Neni 7

Zgjidhja e paqartësive

Palët nënshkruese pajtohen që në rast të ndonjë paqartësie eventuale në mes palëve nënshkruese sa i përket realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi, zgjidhja të bëhet me mirëbesim dhe biseda të ndërsjella mes tyre.

Neni 8

Ky memorandum është i lidhur në dy (2) kopje identike, prej të cilëve secila palë mban nga një (1) kopje.

Nënshkruajnë:

Drejtor i organizatës "Qatar Charity"
z. Mahmoud Abbas Shaker



قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

Kryetar i Komunës së Lipjanit
z. Imri Ahmeti

